

Depozitat

Rishikoni normat e interesit të depozitave, afatet e maturimit, opsionet e pagesës së interesit, kushtet e tërheqjes së parakohshme, trajtimin tatimor dhe informacionin mbi sigurimin e depozitave në Jet Bank.

Depozita me Afat Lekë	
Afati i Maturimit	Norma vjetore e interesit
1 muaj	1%
3 muaj	1.5%
6 muaj	2%
12 muaj	3.5%
24 muaj	3.7%
36 muaj	4%

Depozita me Afat EUR	
Afati i Maturimit	Norma vjetore e interesit
1 muaj	1%
3 muaj	1.5%
6 muaj	2%
12 muaj	3.5%
24 muaj	3.7%
36 muaj	4%

Çfarë përfaqësojnë afatet e maturimit në tabelë?

Afatet e maturimit të shfaqura në buletin janë afatet e disponueshme për depozitën me afat. Për çdo afat maturimi, shfaqet norma e interesit të aplikueshëm bazuar në monedhën dhe kushtet në fuqi.

A është norma e interesit e fiksuar?

Po. Norma e interesit është e fiksuar për të gjithë afatin e depozitës. Kjo do të thotë se pasi depozita është hapur, norma nuk ndryshon deri në maturim, dhe ju e dini që nga fillimi se sa interes do të fitoni bazuar në shumën, afatin dhe monedhën e përzgjedhur.

Cila është shuma minimale e kërkuar për të hapur një depozitë?

Shuma minimale e kërkuar për të hapur një depozitë është:

- **50,000 ALL**
- **500 EUR**

Kur mund ta merrni interesin?

Ju mund të zgjidhni se kur dëshironi ta merrni interesin, në varësi të opsioneve të disponueshme për çdo afat. Interesi mund të paguhet:

- Parandaj (upfront);
- Çdo muaj;
- Çdo vit;
- Në maturim.

Jo çdo opsion mund të jetë i disponueshëm për çdo afat maturimi. Opsionet e disponueshme do të shfaqen gjatë procesit të hapjes së depozitës.

A ndryshon norma e interesit nëse zgjidhni ta merrni interesin më herët ose më vonë?

Jo. Momenti i pagesës së interesit nuk e ndryshon normën e interesit. Norma mbetet ajo që aplikohet për monedhën, shumën dhe afatin e maturimit të përzgjedhur.

Si llogaritet interesi?

Interesi llogaritet duke përdorur formulën e mëposhtme:

$$\text{Interesi} = (\text{Norma e Interesit} / 365) \times \text{Shuma e Depozitës} \times \text{Numri i Ditëve}$$

Ku:

- **Norma e Interesit** është norma vjetore e interesit;
- **Shuma e Depozitës** është shuma e vendosur në depozitë;
- **Numri i Ditëve** është periudha gjatë së cilës depozita qëndron aktive.

A mund ta mbyllni depozitën përpara maturimit?

Po. Ju mund të kërkonti mbylljen e depozitës përpara maturimit. Për të bërë këtë, duhet të njoftoni Bankën dhe të paraqisni një kërkesë për mbyllje të parakohshme në përputhje me procedurat e Bankës.

Çfarë ndodh me interesin nëse depozita mbyllet përpara maturimit?

Trajtimi varet nga afati i maturimit të depozitës:

- Për depozitën **12-mujore**, edhe nëse depozita mbyllet përpara maturimit, ju fitoni interes për periudhën gjatë së cilës depozita ka qenë aktive.
- Për **afatet e tjera të maturimit**, në rast të mbylljes së parakohshme, ju humbisni të gjithë interesin e përlogaritur.

Për këtë arsye, përpara se të përzgjidhni afatin, duhet të vlerësoni nëse mund t'ju nevojiten fondet përpara maturimit.

A mund të rinovohet automatikisht depozita?

Po. Ju mund të zgjidhni rinovimin automatik të depozitës në maturim. Nëse zgjidhni rinovimin automatik, depozita do të rinovohet bazuar në kushtet në fuqi në momentin e rinovimit. Përpara rinovimit, Banka do t'ju njoftojë për kushtet e reja, duke përfshirë normën e interesit, afatin e maturimit dhe çdo element tjetër të aplikueshëm.

A aplikohet tatim mbi interesin e fituar nga depozita?

Po. Një tatim në burim prej 15% aplikohet mbi interesin e fituar nga depozita me afat. Ju nuk keni nevojë ta llogaritni apo ta paguani këtë tatim veçmas. Banka e mban tatimin automatikisht kur paguhet interesi dhe krediton ose paguan vetëm shumën neto të interesit, bazuar në opsionin e pagesës së interesit të përzgjedhur për depozitën.

A janë depozitat të siguruara?

Po. Depozitat janë të siguruara nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD), sipas skemës ligjore të sigurimit të depozitave në Republikën e Shqipërisë. Mbulimi maksimal është deri në 2,500,000 Lekë (ALL) për çdo depozitues, në çdo bankë, pavarësisht nga numri i depozitave ose monedha në të cilën ato mbahen. Nëse mbani disa depozita ose llogari në të njëjtën bankë, ato trajtohen së bashku për efekt sigurimi, deri në limitin maksimal të mbulimit ligjor.